



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:179282

Datë: 07.11.2024

Numri i dokumentit: 06417357

PPP.nr.1096/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si përmbarimore me gjyqtarin individual Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Berisha, në çështjen juridike të kreditorit Oda e Mjekëve te Kosovës me seli ne QKUK –Instituti A, kati i III, Prishtine, te cilën e përfaqëson P.S, Kryetar i OMK-Prishtinë, kundër debitorit Dr. B.Snga Mitrovica rr, “S..” nr.., te cilin e përfaqëson Granit Vokshi avokat me seli ne Prishtinë, lidhur me kompensimin e gjobës për shkelje etike-profesionale ne lartësi prej ..., gjykata duke vendosur sipas prapësimit të parashtruar nga debitori me datë .., kundër Urdhrit mbi lejimin e Përmbarimit, gjykata jashtë seancës gjyqësore me datën 07.11.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit B.S. nga Mitrovica, ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit ..., të datës .., sipas propozimit të kreditorit Oda e Mjekëve te Kosovë, me seli ne QKUK - Prishtinë.
- II.** Mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor ..., I datës ..., i lejuar nga Përmbaruesi Privat, K.M. i caktuar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Kreditori Oda e Mjekëve te Kosovë, me seli ne QKUK – Prishtinë, ka ushtruar propozimin për përmbarim te përmbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorit Dr. B.S nga Mitrovica rr, “...” nr..., te cilin e përfaqëson Granit Vokshi avokat me seli ne Prishtinë, lidhur me kompensimin e gjobës për shkelje etike-profesionale ne lartësi prej ..., si dhe shpenzimet e procedurës ne shumen prej ... nën kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm, te gjitha këto në afat 7 ditor nga dita e pranimet te urdhrit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, neper te gjitha Bankat Komerciale ne emër te debitorit, duke e bere pagesën me bartje te mjeteve financiare përkatëse nga llogaria e debitorit.

Përmbartuesi privat Kushtrim Metaj, me urdhrin përmbartimit ..., të datës ..., e ka lejuar propozimin për përmbartim në këtë çështje përmbartimore.

Debitori Dr. B.S nga Mitrovica, nëpërmes të autorizuarit të tij Granit Vokshi avokat nga Prishtina, ka paraqitur prapësim kundër dokumentin administrativ – vendimi nr. ..., i datës ..., si dhe Urdhrit për Ekzekutim nr. ..., me pretendimin se i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbartim duke i propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i themeltë prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet Urdhri Përmbartimor P.nr....., i datës ..., i lejuar nga Përmbartuesi Privat, K.M.me adrese në rrugën R. L., Prishtinë.

Kreditori në afatin e parashikuar ligjor ka bërë përgjigje në prapësimin e debitorit, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta refuzoi si të pabazuar për faktin se fillimisht pretendimet të cilat janë përfshirë në prapësim nuk janë objekt i mjetit të rregullt juridikisht dhe si të tilla nuk kanë karakter juridiko material, se vendimi . i përmbush të gjitha kushtet ligjore që të konsiderohet titull ekzekutiv i cili duhet të përmbartohet në këtë procedurë përmbartimore, andaj prapësimi i debitorit është i pa mbështetshëm në kuptim ligjor dhe është tërësisht i përfshirë jashtë shkaqeve ligjore të përkufizuara në nenin 71 të LPP-se, gjykatës i propozoi që të vërtetohet Urdhri përmbartimor P.nr ...

Gjykata Themelore Mitrovicë, si përmbartimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sa i përket pretendimeve të debitorit i cili kundërshton urdhrin për përmbartim për shkak të shkeljeve të procedurave përmbartimore, pretendimet e lartcekura gjykata i refuzoi si të pa bazuara, për faktin se kreditori propozimin për përmbartim e ka iniciuar në bazë të vendimi nr. ..., i datës .., si dhe Urdhrit për Ekzekutim nr. KE.02-5/2020, e sipas nenit 22 par.2 të LPP-së, konsiderohet dokument i ekzekutueshëm përmbartues dhe është i përshtatshëm për përmbartim, se debitori i obligohet kreditorit si në propozim për përmbartim lidhur me kompensimin e gjobës për shkelje etike-profesionale në lartësi prej ..., si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej Debitori në prapësimin e tij në asnjë nga pretendim të tij në prapësim e parashtruar nuk e ka bazuar në ndonjë nga pikat që sipas ligjit me saktësisht nenit 71 të LPP-se, janë parapare si shkaqe mbi bazën e se cilave

mund të bazohet prapësimi. Gjykata në këtë procedurë nuk ka tagër të lëshohet në çështjen meritorë për të cilat kanë qene pjese e pretendimeve të debitorit në prapësimin e parashtruar.

Gjykata rithekson se i gjithi pretendimi i debitorit në prapësim ka qene i orientuar në kontestimin e vendimit mbi bazën e të cilit është iniciuar kjo procedurë dhe atë për gjendjen faktike të vërtetuar dhe të drejtën materiale të zbatuar mbi të.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 29 paragrafi 1.3 dhe paragrafi 3, 69, 71, 73 paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.1096/2020, datë 07.11.2024

GJYQTARI,

Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.